



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:143834
Datë: 17.01.2024
Numri i dokumentit: 05200150

PML.nr.01/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës në çështjen penale ndaj të pandehurit L. H. etj., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “*Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal*” sanksionuar nga neni 277, paragrafi 2. Lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), lidhur me veprën penale “*Kontrabandimi me migrantë*” në bashkëkryerje nga neni 164, paragrafi 1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, avokati Bajram Dili, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PPS nr.46/2023 të datës 17.11.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.S.nr.228/2023 të datës 30.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit L. H., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PPS nr.46/2023 të datës 17.11.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.S.nr.228/2023 të datës 30.11.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, me aktvendimin PPS nr.46/2023 të datës 17.11.2023, të pandehurit L. H., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal” sanksionuar nga neni 277, paragrafi 2. Lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale “Kontrabandimi me migrantë” në bashkryerje nga neni 164, paragrafi 1 të KPRK, i ka caktuar vazhduar masën e paraburgimit deri më 20.01.2024. Të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., e 1.2., pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3., të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN1.S.nr.228/2023 të datës 30.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit L. H. etj., dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit L. H., avokati Bajram Dili, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale për vazhdimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t`a aprovoj në tersi si të bazuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit të parashtruar kundër aktvendimeve të atakuara , të anulohen aktvendimet e atakuara ashtu i që mbrojturi i tij të lirohet nga paraburgimi, ose t`i caktohet ndonjë masë alternative më të butë .

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.01/24 e datës 04.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pa bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit L. H., thekson se aktvendimet e atakuara me kërkesë me të cilat të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, arsyetimet janë vetëm përshkrim i dispozitave ligjore, por jo edhe argumentim dhe arsyetim se cilat janë ato shkaqe që e bëjnë të domosdoshëm për vazhdimin e paraburgimit. Tutje në kërkesë theksohet se gjykata përveç dyshimit të bazuar si kusht thelbësor për vazhdimin e paraburgimit ka dështuar të arsyetoj edhe bazat tjera të veçanta. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, pse ekziston rreziku i ikjes për shkak se për veprat penale që dyshohet se i ka kryer i pandehuri parashihet dënim mjaft i lartë nëse shpallet fajtor edhe pse edhe me masa tjera alternative ka mundur lehtë të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë. Po ashtu theksohet në kërkesë se i mbrojturi i tij nuk paraqet kurrfarë rreziku të ndikimit në dëshmitar, të dëmtuar e po ashtu pa e potencuar as faktin se në të

cilët dëshmitar mund të ndikoj. Nuk ka as rrezik të përsëritjes së veprës penale, se kjo masë është shqiptuar në formë ndëshkimi duke mos marrë parasysh parimin e proporcionalityt dhe parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin In dno pro re-parimi i të vërtetës materiale si dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësor, të nenit 5 të GJEDNJ dhe nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kur heqja e lirisë mund të bëhet vetëm atëherë kur ka shkaqe bazuara qartë se i pandehuri ka kryer veprën penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit janë të pabazuara, ngase aktvendimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa kanë dhënë arsye të mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit dhe nuk përmbajnë shkelje ligjore për të cilat pretendohet, pasi që siç rezultojnë nga shkresat e çështjes, i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se a do të vërtetohen këto fakte mbetet të vlerësohen në faza tjera të procedurës penale, me çka është plotësuar kushti i përgjithshëm ligjor nga neni 184, paragrafi 1., nën- paragrafi 1.1., i KPP, për vazhdimin e paraburgimit.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore edhe më tutje për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit L. H. nga dispozita ligjore e nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.1 të KPP, nga se ekziston rreziku i ikjes apo arratisjes për t'iu shmangur përgjegjësisë penale dhe pengimin e procedurës penale, kjo për faktin se i njëjti posedon dokument të udhëtimit-pasaportë të shtetit të Sirisë dhe për faktin se i njëjti nuk ka ndonjë adresë të përkohshme brenda Kosovës, shton dyshimi se i pandehuri, mund të ik apo arratiset për t'iu shmangur përgjegjësisë penale.

Qëndron, baza ligjore edhe nga dispozita e nenit 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.2 të KPP për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit L. H. për faktin se po të gjendet i i pandehuri duke u mbrojtur në liri mund të pengojë zhvillimin normal të procedurës penale, për faktin se procedura penale është në fazën fillestare dhe se para prokurorit duhet të dëgjohen edhe të pandehurit tjerë dhe se me qëndrimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku se i njëjti mund të ndikoj tek të njëjtit në deklarinimin e tyre në favor të tij, prandaj vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm sa i përket pengimit të ndikimit dhe mbarëvajtjes së procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit L. H., edhe sipas dispozitës së nenit 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke marrë parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, karakteristikat e tija personale, ku i njëjti e shfrytëzon rastin për kontrabandimin e migrantëve, veprim ky i ndaluar dhe bënë pjesë në kapitullin e veprave penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura në të drejtën ndërkombëtare dhe duke marrë parasysh ndikimin negativ në shoqëri, e po ashtu edhe sigurinë e qytetarëve, rrethanë që tregon se vazhdimi i masës së paraburgimit është më se i domosdoshëm në këtë fazë të procedurës.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç pretendohet në kërkesën e mbrojtjes, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme,

ndërsa masat tjera alternative nga neni 171 i KPP, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.01/24, më datë 09.01.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj